

Përshëndetje të nderuar,

Unë, **Bajram Thaqi** nga Prishtina, pronar i parcelave kadastrale me nr. 421-3, 422-8, 422-9 dhe 423-8, ZK. Çagllavice, Prishtinë, të shtrira në kuadër të Planit Rregullues Urban - Prishtina e Re - Zona Perëndim, Blloku H-5 dhe H-7, ju njoftojmë se kemi zhvilluar disa takime me kompaninë ndërtuese “SHALA GROUP” SH.P.K. me seli në Prishtinë, Çagllavicë, Rruga e Gjilanit, Nr. 233/5, me NUI 810030726, për të arritur një marrëveshje për ndërtimin e përbashkët dhe zhvillimin e projektit në blloqet e lartpërmendura. Unë, si pronar i parcelave, kam ofruar një ofertë, e cila është refuzuar nga kompania e lartpërmendur.

Me këtë rast, kërkoj nga ju që në asnjë rast, të mos vazhdoni me procedura për t'i pajisur me kushte dhe leje ndërtimore parcelat e mia dhe ato fqinjë që tangjentojnë me parcelat e lartpërmendura, pa pëlqimin tim. Parcelat e mia duhet të trajtohen brenda dy blloqeve urbane të përcaktuara në bazë të planit rregullues. Çdo përpjekje për t'a pajisur ndonjë subjekt juridik ose person fizik me kushte ndërtimore në këto prona do të përbënte vepër penale dhe cenim të drejtës absolute në pronë si kategori kushtetuese dhe parimeve të mbrojtjes së të drejtës pronësore, transparencës në procedurat administrative dhe promovimit të interesave të përbashkëta të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, bazuar në ligjet në fuqi për planifikimin hapësinor dhe për ndërtim.

Faleminderit për vëmendjen tuaj.

Me respekt

Bajram Thaqi